

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8328
E enjte, 25 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Kërkohej dorëheqja e Abdixhikut nga drejtimi i LDK-së

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HARADINAJ: PA NJË MARRËVESHJE MES PARTIVE OPOZITARE, KOSOVA DO TË VAZHDOJË TË JETOJË NË 'EPOKËN KURTI'

FAQE 4-5



Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se mundësia e një fronti të bashkuar opozitar po i jep mundësi Kurtit ta vazhdojë agjendën politike. Ai ka theksuar se

vetëm një bashkim i opozitës, me një kontratë të qartë politike dhe me një kandidat të përbashkët për president, mund ta ndryshojë situatën aktuale politike në vend. Sipas

tij, mundësia e një alternative të organizuar opozitare po i jep mundësi Kurtit t'i vazhdojë politikën e tij dhe ta çojë vendin sërisht në zgjedhje

KRYESIMI IRLANDEZ ME BE-në KTHEN NË FOKUS ZGJERIMIN, POR PA KOSOVËN

F. 3



ENDRIT THAÇI TAKON EDI RAMËN: FALEMINDERIT QË QËNDRUAT NË ANËN E SË VËRTETËS KUR SHUMË TË TJERË ZGJODHËN HESHTJEN

F. 3



AKB-ja: KOSOVA NUK DUHET TA HUMBASË MUNDËSINË HISTORIKE TË PARTNERITETIT ENERGETIK ME SHBA-në

F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



TRUMPI, ROL KRYESOR NË FINALEN E BOTËRORIT

F. 11

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja ZGJAT EMERGJENCËN KOMBËTARE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

WASHINGTON, 24 QERSHOR - Shtëpia e Bardhë ka bërë me dije përmes një njoftimi se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka vendosur ta zgjasë emergjencën kombëtare në lidhje me Ballkanin Perëndimor të paktën deri më 26 qershor të vitit 2026. Kjo emergjencë ishte shpallur për herë të parë me urdhër ekzekutiv më 2001, por sipas një njoftimi të Shtëpisë së Bardhë, të publikuar në Regjistrin Federal më 24 qershor, ajo do të zgjatet edhe përtej 26 qershorit të këtij viti shkaku i gjendjes në Ballkanin Perëndimor.

Në njoftim thuhet se “veprimet e personave që kërcënojnë paqen dhe përpjekjet ndërkombëtare për stabilizim në Ballkanin Perëndimor” dhe gjendja e tanishme në këtë rajon “paraqesin një kërcënim të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm për sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara”. “Për këtë arsye...



emergjenca kombëtare e shpallur me urdhër ekzekutiv lidhur me Ballkanin Perëndimor, duhet të vazhdojë përtej qershorit 2026”, thuhet në njoftim.

Urdhri ekzekutiv për gjendjen në Ballkanin Perëndimor u miratua për herë të parë më 26 qershor 2001, nga ish-presidenti George W. Bush, pas luftërave në këtë rajon.

Më pas, më 2021, ShBA-ja kishte zgjeruar fushëveprimin e kësaj

emergjenca kombëtare, pasi që u tha se vendet e ish-Jugosllavisë dhe Shqipëria janë përballur, gjatë dy dekadave të fundit, me korrupsion dhe veprime që pengojnë marrëveshjet e arritura pas luftës.

Ky vendim mund të jetë sinjal se Uashingtoni vazhdon ta shohë Ballkanin Perëndimor si shqetësim për sigurinë dhe stabilitetin, posaçërisht në Kosovë dhe Bosnjë-

Hercegovinë, cilat shihen si vende ende të cënueshme.

Në një raport në maj, Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) e paraqiti Ballkanin Perëndimor si rajon me rëndësi të drejtpërdrejtë për sigurinë dhe interesat ekonomike amerikane.

Raporti i DASH-it identifikoi Rusinë dhe Kinën si aktorë keqdashës që synojnë të përfitojnë nga paqëndrueshmëria, korrupsioni dhe dobësitë në qeverisje në rajon, por nënvizon gjithashtu angazhimin e ShBA-së për t’iu kundërvënë ndikimit të tyre. Gjendja e sigurisë në Kosovë ka qenë e qetë në vitet e fundit, por vendi është përballur me një krizë institucionale duke mbajtur zgjedhjeve të njëpasnjëshme në gati dy vjetet e fundit për shkak të mungesës së konsensusve politike brenda partive partiake.

Në anën tjetër, NATO-ja njoftoi më 12 qershor se, gjatë vitit të ardhshëm, do ta bëjë një

përshtatje graduale të pranisë së saj në Kosovë, duke reflektuar vlerësimin për një situatë të qëndrueshme të sigurisë në vend.

Nërkohë, Bosnjë-Hercegovina është ende në pritje të emërimit të një përfaqësuesi të ri ndërkombëtar, pasi Christian Schmidt njoftoi dorëheqjen më herët këtë muaj. Kjo çështje ka shkaktuar përplasje në Bosnjë lidhur me zyrën ndërkombëtare që mbikëqyr zbatimin e paqes. Entiteti i Bosnjë-Hercegovinës, Republika Sërpska, miratoi në maj deklaratën për mbylljen e zyrës së përfaqësuesit të lartë, gjë që u kundërshtua nga partitë politike nga entiteti tjetër, Federata e Bosnjë-Hercegovinës, të cilat thanë se ajo duhet të mbetet në Bosnjë me kompetenca të plota.

SENATI AMERIKAN VOTON PËR NDALIMIN E LUFTËS ME IRANIN PA AUTORIZIMIN E KONGRESIT

Uashington, 24 qershor - Senati i Shteteve të Bashkuara ka votuar me një shumicë të ngushtë për kalimin e një projektligji që kërkon ndalimin e luftës me Iranin dhe detyron presidentin amerikan, Donald Trump, ta kërkojë lejen e Kongresit për ta rifilluar luftën. Trumpi e kritikoi ligjin si të “pakuptimtë”. Kjo është rezoluta e parë për kompetencat e luftës që merr mbështetje si në Dhomën e Përfaqësuesve ashtu edhe në Senat.

Legjislacioni u miratua më 23 qershor me 50 vota për dhe 48 kundër në Senat, pasi katër senatorë republikanë iu bashkuan demokratëve.

Ligji kërkon që Trumpi t’i tërheqë forcat amerikane nga konflikti me Iranin, përveç rasteve kur Kongresi autorizon në mënyrë të qartë veprimet ushtarake në rajon. Ai nuk do t’i dërgohet

Trumpit për nënshkrim dhe miratim, dhe nuk është e qartë tani për tani se si do të ndikojë ajo në konfliktin në mes të Teheranit dhe Uashingtonit, të cilët janë duke zhvilluar bisedime për një marrëveshje për paqe në kuadër të një armëpushimi të brishtë. “Me miratimin në Senat të Rezolutës sime për Kompetencat e Luftës ndaj Iranit, të dy dhomat e Kongresit e kanë bërë tashmë të qartë se presidenti nuk mund të vazhdojë këtë luftë të zgjedhur dhe duhet t’i ndërpresë të gjitha armiqësitë kundër Iranit”, tha pas votimit Gregory Meeks, demokrati me rangun më të lartë në Komisionin për Punët e Jashtme. “Pavarësisht se çfarë thotë presidenti Trump, kjo masë është detyruese sipas Rezolutës për Kompetencat e Luftës dhe unë do t’i shqyrtoj të gjitha rrugët ligjore për t’u siguruar që



pushteti ekzekutiv t’i përmbahet vullnetit të Kongresit”, shtoi Meeks.

Nërkohë, Trumpi e kritikoi Kongresin për kalimin e këtij ligji, duke thënë se ai “vjen në një kohë të paduhur dhe është i pakuptimtë”. “Këta senatorë sapa ma kanë bërë punën më të

vështirë, por unë do ta kryej atë, në një mënyrë ose në një tjetër, sepse unë gjithmonë e kryej punën”, u ankuua Trumpi në platformën sociale “Truth Social”. Ai shkroi se, pikërisht në një kohë kur Irani është “i gatshëm të na japë gjithçka” dhe po “tregon respekt të jashtëzakonshëm ndaj

Shteteve të Bashkuara” dhe ndaj tij personalisht, “Senati i ShBA-së vendos të zhvillojë një votim të keqe dhe të pakuptimtë për Aktin e Kompetencave të Luftës, duke i treguar sponsorizuesit numër një të terrorizmit në botë se Shtetet e Bashkuara nuk e mbështesin atë që unë po u bëj atyre dhe se duhet të ndalem”.

Trumpi iu referua Iranit si “sponsorizuesi numër një i terrorizmit në botë”, duke përsëritur një akuzë që administrata e tij e ka përdorur shpesh ndaj Teheranit.

Në muajt e fundit senatorët demokratë kanë paraqitur vazhdimisht projektligje për ta ndaluar luftën, por ato janë rrëzuar nga shumica republikane.

Republikanët, gjithashtu, mbajnë një shumicë të ngushtë në Dhomën e Përfaqësuesve.

Turqia arreston mbi 200 persona para Samitit të NATO-s

ANKARA, 24 QERSHOR - Policia turke ka arrestuar më shumë se 200 persona të dyshuar për lidhje me grupin militant, Shteti Islamik, dhe me grupe të ndaluar të së majtës ekstreme. Operacioni u zhvillua në prag të samitit të NATO-s, që do të mbahet më 7 dhe 8 korrik në Ankara.

Zyra e Prokurorit në Ankara tha se 209 persona janë ndaluar në kryeqytet, ndërsa 32 të tjerë mbeten në arrati. Nga të ndaluarit, 185 dyshohen për anëtarësi në disa organizata të majta ekstreme, të cilësuar si terroriste nga Ankaraja. Mes tyre është edhe Fronti-Partia Revolucionare e Çlirimit

të Popullit (DHKP-C), që në të kaluarën ka marrë përgjegjësinë për disa sulme në Turqi. Autoritetet thanë se operacionet kishin në shënjestër disa grupe, si pjesë e masave më të gjera të sigurisë.

Zyra e Governorit të Ankarasë njoftoi të hënën vonë për ndalimin e të gjitha protestave

nga 28 qershori deri në fund të samitit të NATO-s.

Samiti pritet të mbledhë liderët e 32 shteteve anëtare, përfshirë edhe presidentin amerikan, Donald Trump. Ai do të zhvillohet në një moment kritik për sigurinë evropiane dhe euroatlantike. Muajt e fundit Aleanca është



vënë nën presion - edhe për shkak të ndryshimeve në politikën e ShBA-së, që shkojnë përtej kërkesave për ta forcuar shtyllën evropiane të NATO-s.

HARADINAJ: PA NJË MARRËVESHJE MES PARTIVE OPOZITARE, KOSOVA DO TË VAZHDOJË TË JETOJË NË 'EPOKËN KURTI'

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se mungesa e një fronti të bashkuar opozitar po i jep mundësi Kurtit ta vazhdojë agjendën politike. Ai ka theksuar se vetëm një bashkim i opozitës, me një kontratë të qartë politike dhe me një kandidat të përbashkët për president, mund ta ndryshojë situatën aktuale politike në vend. Sipas tij, mungesa e një alternative të organizuar opozitare po i jep mundësi Kurtit t'i vazhdojë politikën e tij dhe ta çojë vendin sërish në zgjedhje

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Ish-kryetari i AAK-së dhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se opozita nuk ka arritur të krijojë një marrëveshje të përbashkët politike dhe një kandidat të përbashkët, duke vlerësuar se në këto rrethana vendi do të vazhdojë të udhëhiqet nga agenda e Lëvizjes Vetëvendosje dhe e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti.

Haradinaj ka theksuar se vetëm një bashkim i opozitës, me një kontratë të qartë politike dhe me një kandidat të përbashkët për president, mund ta ndryshojë situatën aktuale politike në vend. "Ne po jetojmë në epokën Kurti, që i bie se ai, kur i ka 40 % ose mbi 40 deputetë, do ta zbatojë agjendën e tij në Kosovë. Ndikimi ynë, ose ne do të mund të mos jetonim vetëm në epokën e tij, por edhe në epokën e të tjerëve, sikur të kishim një kontratë të përbashkët si opozitë. Pra,

AAK-ja, LDK-ja dhe PDK-ja, edhe një plan konkret, një kandidaturë konkrete", është shprehur Haradinaj. Sipas tij, mungesa e një alternative të organizuar opozitare po i jep mundësi Kurtit t'i vazhdojë politikën e tij dhe ta çojë vendin sërish në zgjedhje. "Përderisa nuk kemi një kontratë dhe nuk kemi një ofertë, ne jetojmë në epokën Kurti, në agjendën Kurti dhe ai do ta zbatojë atë që di më së miri, një lloj eksperimentimi me Kosovën, dhe do të na dërgojë në zgjedhje prapë. Pra, kjo është ajo që di dhe ajo që po ndodh. Nga përvoja ime e gjatë politike, unë po e lexoj këtë", ka thënë ai.

Haradinaj ka folur edhe për mundësinë e zgjedhjes së presidentit, duke thënë se opozita mund të bëhet faktor vendimtar nëse arrin një marrëveshje të përbashkët. "Opozita mundet, pra të hyjë dhe të jetë faktor në marrjen e fatit të vendit në dorë, duke pasur një kontratë mes vete dhe një kandidaturë për president. Nëse dikush nga opozita e merr mbështetjen e



opozitës, gjithsesi që do ta mbështesja. Nëse do të isha i propozuar (për president), do ta shqyrtoja. Pra, nuk jam kandidat, nuk kam kushte, nuk kam kërkesë për askënd. Ne nuk bëhemi pjesë e qeverisjes ose e vazhdimin të qeverisjes Kurti, sepse e kemi shpjeguar disa herë sa e dëmshme dhe sa humbje është për Kosovën. Po e them edhe një herë, përderisa IV-ja nuk bie nën 40 %, do të jetojmë në epokën Kurti, në agjendën Kurti, në eksperimentin Kurti. Mund ta pengojmë këtë, mund ta ndryshojmë vetëm nëse bëhemi bashkë ne, opozita", ka thënë Haradinaj. Kryeministri në detyrë, Albin

Kurti, ka deklaruar të mërkurën se Kosova nuk kishte nevojë për zgjedhje të reja dhe, sipas tij, ky rezultat e dëshmon këtë, të cilën e kishte ripërsëritur, para se ato të ndodhnin. "Sido që të jetë, qytetarët folën sërish qartë. Rezultati duhet të pranohet e respektohet dhe vullneti i popullit të zbatohet e të përkthehet në institucione funksionale e demokratike, të angazhuara e të përkushtuara për zhvillim e mirëqenie, arsim e shëndetësi, për siguri e mbrojtje, industri e prodhim, investime të mëdha infrastrukturore nga hekurudhat te digat, e jo vetëm. Andaj, porsa të

certifikohet rezultati i zgjedhjeve, do ta nisim punën dhe diskutimet për formimin e institucioneve të reja: konstituimin e legjislaturës së njëmbëdhjetë të Kuvendit, formimin e qeverisë së re dhe zgjedhjen e presidentit apo presidentes", ka theksuar Kurti. Ndërkaq profesori i së Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka vlerësuar se zgjedhja e presidentit apo presidentes së Kosovës duhet të jetë prioritet pas konstituimit të Kuvendit, më pas të formohet qeveria. Ai ka paralajmëruar se moszgjedhja e kësaj shtetit brenda afatit kushtetues prej 60 ditësh do ta çonte vendin në zgjedhje të reja.

Kosova ka mbajtur zgjedhjet e treta parlamentare brenda një viti e gjysmë dhe tani duhet ta zgjedhë presidentin e ri.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) planifikon që certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit ta bëjë deri më 6 korrik. Sipas Kushtetutës së vendit, seanca konstituive e Kuvendit duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 53 ulëse, Partia Demokratike e Kosovës 22, Lidhja Demokratike e Kosovës 18 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7.

Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet pakicë - dhjetë për serbët, dhjetë për të tjerat.

QEVERIA MIRATON NJË SËRË VENDIMESH: 3 MILIONË EURO PËR MËRGATËN

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt, në të cilën ka miratuar një varg vendimesh që përfshijnë investime në infrastrukturë, ndarje të mjeteve buxhetore, emërimet në institucione publike dhe iniciativë për projekte zhvillimore. Ndër vendimet kryesore është riallokimi i 1.15 milion eurove për katër projekte të reja kapitale në kuadër të programit të bashkëfinancimit me komunat, si dhe riallokimi i 1.05 milion eurove për katër projekte të tjera infrastrukturore në bashkëpunim me komunat përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit

Lokal. Qeveria miratoi gjithashtu ndarjen e tre milionë eurove për zbatimin e Masës 4.5 "Mbështetja e Mërgatës" në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Në sektorin e drejtësisë u vendos pezullimi i ekzekutimit të Rregullores për pranimin dhe trajtimin e thirrjeve telefonike në sistemin e caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare (Ex-Officio) si dhe pezullimi i aktit administrativ të Odës së Avokatëve të Kosovës lidhur me lartësinë e shpenzimeve për regjistrim deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente. Po ashtu, është miratuar emërimi i Komisionit për



Kompensimin e Viktimave të Krimin dhe është aprovuar kërkesa për ndarjen e 200 mijë eurove për furnizimin dhe instalimin e një gjeneratori të ri në Burgun e Sigurisë së Lartë. Në këtë mbledhje u emërua edhe Bordi i Përkohshëm i

Drejtorëve të ndërmarrjes publike "Infracos" Sh.A., me Getuar Zogun në cilësinë e kryesuesit, ndërsa anëtarë u emëruan Detrina Alishani Sopi, Fjolla Gashi dhe Genc Hundozi. Qeveria miratoi gjithashtu nismën për Marrëveshjen e

Grantit për projektin KOMPAS, i cili synon forcimin e sistemit shëndetësor në Kosovë si dhe aprovoi ndarjen e mbi 44 mijë eurove për përfundimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Shtimes. Ndër vendimet e tjera u miratua qiradhënia për 15 vjet e një sipërfaqeje në zonën kadastrale të Seqishtit në Han të Elezit për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror si dhe u hap rruga për shqyrtimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit për projekte rrugore në Han të Elezit dhe Prizren.

Qeveria theksoi se këto vendime synojnë përmirësimin e infrastrukturës, forcimin e shërbimeve publike dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik në vend.

KRYESIMI IRLANDEZ ME BE-në KTHEN NË FOKUS ZGJERIMIN, POR PA KOSOVËN

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Irlanda do ta marrë kryesimin e presidencës gjashtëmujore me rotacion të Këshillit të Bashkimit Evropian (BE) më 1 korrik, dhe kjo periudhë prej gjysmë viti do të jetë e rëndësishme për zgjerimin e bllokut për disa arsye.

Derisa Mali i Zi mund t'i përmbyllë bisedimet nën drejtimin irlandez, duke e vendosur në binar për t'u bërë anëtar i 28 i BE-së deri në vitin 2028, Kosova nuk pritet të jetë fare pjesë e agjendës.

Ndërkohë, Ukraina, Moldavia dhe Shqipëria gjithashtu pritet ta vazhdojnë përparimin e tyre drejt anëtarësimit, ndërsa mund të ketë lëvizje në të njëjtin drejtim edhe për Islandën dhe Serbinë.

Ka gjithashtu interes të madh për faktin se pikërisht Irlanda po e merr stafetën. Dublini e kryesoi presidencën kur BE-ja e kreu zgjerimin e saj të madh të vitit 2004, duke mirëpritur në klub tetë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe Qipron dhe Maltën.

Diplomatët irlandezë theksojnë për Radion Evropa e Lirë (REL) se kjo periudhë ende kujtohet me nostalgji në ishull dhe se sondazhe të shumta tregojnë se irlandezët janë kryesisht mbështetës të zgjerimit të bllokut.

Në Bruksel, Irlanda shihet gjithashtu si një "ndërmjetëse e ndershme" për këtë çështje - një nga pak shtetet anëtare, qeveria e së cilës nuk e ka bllokuar kurrë ndonjë hap të zgjerimit dhe nuk ka asnjë mosmarrëveshje dypalëshe me asnjë nga vendet kandidatë.

Kjo çështje është një nga prioritetet kryesore të Dublinit për muajt e ardhshëm dhe për këtë arsye pritet përparim i konsiderueshëm.

Para se t'i shohim shanset e vendeve që pritet të gëzojnë përparim, një vlerësim për Kosovën dhe vendet e tjera që nuk pritet të jenë në fokus.

Kosova dhe vendet e tjera në vendnumëro

Derisa ka shumë lëvizje në procesin e zgjerimit, katër vende pritet të mbeten në vendnumëro: Kosova, Bosnje e Hercegovina, Gjeorgjia dhe Maqedonia e Veriut.

Kosova përballlet me telashin e mëçm.

Megjithëse e paraqiti aplikimin për anëtarësim në BE në fund të vitit 2022, kërkesa e Kosovës ende nuk i është përcjellë Komisionit Evropian për vlerësim. Arsyeja është se pesë shtetet anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - nuk janë

pajtuar për ta çuar procesin përpara.

Irlanda ka gjasa t'i vërë në sprovë qëndrimet e këtyre pesë vendeve gjatë presidencës së saj. Shteti i fundit anëtar që e provoi këtë ishte Suedia në fillim të vitit 2023, por Stokholmi u shpërfill, veçanërisht nga Madridi.

Pak njerëz në Bruksel besojnë se do të ketë ndryshim në këtë drejtim gjatë muajve të ardhshëm.

Ndërkohë, për shkak të ndërlikimeve të brendshme, Sarajeva ende nuk ka arritur të emërojë një kryenegociator për bisedimet me BE-në. Për më tepër, dy ligje që Brukseli kërkonte që vendi t'i aprovonte, një që lidhet me funksionimin e gjyqësorit dhe një tjetër që synon kufizimin e ndërhyrjeve politike në sistemin gjyqësor, ende nuk janë miratuar.

Në Maqedoninë e Veriut, ndryshimet e nevojshme kushtetuese për të pasqyruar statusin e bullgarëve në vend ende nuk janë miratuar dhe nuk ka tregues se kjo do të ndodhë së shpejti.

Sipas Komisionit Evropian, Gjeorgjia është vend kandidat vetëm në emër. Pas përplasjeve të shumta me Brukselin, Qeveria në Tbilisi ka pezulluar praktikisht çdo përpjekje për të nisur bisedimet e anëtarësimit deri në vitin 2028. Heqja e statusit kandidat konsiderohet e pamundur dhe zyrtarët e BE-së theksojnë se hapi i radhës duhet të vijë nga vetë Gjeorgjia.

Mali i Zi, anëtar i 28 në vitin 2028?

Mali i Zi është padyshim vendi që duhet ndjekur me vëmendje në këtë kohë.

Vendi i vogël i Ballkanit Perëndimor ka mbyllur deri tani 16 nga 33 kapitujt e anëtarësimit, ku secili kapitull përfaqëson një fushë politike në të cilën vendi kandidat duhet t'i përshtatë rregullat dhe legjislacionin e BE-së.

Podgorica dëshiron t'i mbyllë 17 kapitujt e mbetur gjatë presidencës irlandeze. Kryeministri irlandez, Micheal Martin, ishte në Mal të Zi në fillim të qershorit në kuadër të samitit BE-Ballkani Perëndimor dhe theksoi se do të ishte "sfiduese" të përfundonte gjithçka brenda gjashtë muajve të ardhshëm, por se ky ishte synimi i Dublinit.

Qiproja, që aktualisht mban presidencën me rotacion, mund të arrijë t'i mbyllë deri në tre kapitujt të tjerë në fund të qershorit, para se t'ia dorëzojë stafetën Irlandës. Më



pas, irlandezët shpresojnë të mbajnë konferenca të rregullta ndërqeveritare (të njohura në Bruksel si "IGC") gjatë vjeshtës, ku do të mbyllën më shumë kapituj.

Një diplomat i BE-së theksoi se Mali i Zi duhet t'i përfundojë të gjitha negociatat gjatë vitit 2026 ose në fillim të vitit pasues për të arritur synimin që të bëhet anëtar i 28-të i BE-së në vitin 2028. Ky afat pasqyron nevojën që traktati i anëtarësimit të ratifikohet nga të 27 shtetet anëtare të BE-së, një proces që mund të zgjasë një vit - në mos më shumë.

Vlen të përmendet gjithashtu se gjatë presidencës irlandeze janë planifikuar takime më të shpeshta të grupit të posaçëm të punës në Bruksel që merret me hartimin e traktatit të anëtarësimit të Malit të Zi në BE. I krijuar në prill, grupi filloi punën e hartimit në maj dhe, sipas zyrtarëve evropianë me të cilët ka folur REL-in, procesi ka ecur pa probleme deri tani.

Shqipëria, gjithnjë e më afër

Qiproja mund të arrijë gjithashtu t'i mbyllë kapitujt e parë me Shqipërinë në fund të qershorit, por nëse ajo s'e bën, Irlanda pritet ta bëjë këtë në korrik.

Pas hapjes me ritëm të shpejtë të të gjithë kapitujve gjatë viteve 2024-2025, Tirana ka ngecur deri tani në përbushjen e të ashtuquajturave kritere të ndërmjetme në kapitujt 23 dhe 24, të cilët lidhen me sundimin e ligjit. Ajo më në fund arriti t'i përbushë këto kritere në fund të majit.

Meqenëse BE-ja është e

shqetësuar për gjendjen e gjyqësorit dhe të drejtave themelore në shumë vende kandidatë, nuk mjafton vetëm hapja dhe mbyllja e negociatave në këta dy kapituj. Duhet të përbushen kriteret e ndërmjetme. Këto kritere përcaktohen nga të 27 shtetet anëtare të BE-së, të cilat më pas duhet të vendosin njëzëri se ato janë përbushur para se t'i caktojnë kriteret përfundimtare të mbylljes për vendin kandidat.

Pasi ka përbushur kriteret e ndërmjetme për sundimin e ligjit, Shqipëria mund t'i mbyllë së shpejti tre kapitujt anëtarësimi: shkencën dhe kërkimin, arsimin dhe kulturën, si dhe marrëdhëniet e jashtme.

Serbia dhe Islanda po e rrisin ritmin?

Vlen të ndiqen edhe dy vende të tjera që mund të fillojnë të lëvizin gjatë gjashtë muajve të ardhshëm.

Njëri prej tyre është Serbia. Duke parë se Mali i Zi dhe Shqipëria që po ecin me ritëm të shpejtë, Beogradi është i etur ta rifillojë përparimin, pasi ka ngecur në rrugën drejt BE-së që nga fundi i vitit 2021. Në korridorët e BE-së qarkullojnë thashetheme se vendi mund ta hapë një grup të tërë kapitujsh, kryesisht të lidhur me ekonominë dhe konkurrueshmërinë, qysh në korrik, veçanërisht sepse Franca po shtyn që kjo të ndodhë.

Megjithatë, të tjerë vazhdojnë të ngurrojnë.

Shtetet baltike janë të shqetësuara pse Serbia nuk e përfill politikën e sanksioneve

të BE-së ndaj Rusisë, edhe pse qëndrimi i tyre i ashpër në këtë çështje nuk është më aq parimor sa dikur.

Pastaj janë vende, veçanërisht Holanda, të cilat nuk dëshirojnë ta shohin Beogradin duke përparuar në procesin e anëtarësimit në BE së shpejti, për shkak të problemeve serioze me sundimin e ligjit në vend. Megjithatë, kjo është diçka që ia vlen të ndiqet në muajt në vijim.

Pastaj është Islanda.

Shteti ishullor aplikoi për t'u anëtarësuar në BE në vitin 2009, pasi u trondit nga një krizë financiare.

Duke nisur negociatat e anëtarësimit pak kohë më pas, ai arriti t'i mbyllë 11 nga 33 kapitujt negociues, derisa një qeveri e re njoftoi Brukselin në vitin 2013 se - me BE-në në mes të krizës së eurozonës - po pezullonte bisedimet.

Kjo ndodhi gjithashtu gjatë kryesimit të presidencës BE-së nga Irlanda në atë kohë.

Në një kthesë interesante historike, Islanda do të mbajë një referendum në fund të gushtit për të vendosur nëse do t'i rifillojë negociatat e anëtarësimit. Dhe, Irlanda është sërish në krye në rast se islandezët votojnë pro, gjë që sondazhet tregojnë se mund të ndodhë, megjithëse diferenca është e ngushtë.

Kjo mundësi nuk ka kaluar pa u vënë re në Irlandë. Ministri irlandez për Evropën, Thomas Byrne, ka deklaruar se islandezët "i pezulluan negociatat e tyre gjatë presidencës së fundit irlandeze. Prandaj, nëse do t'i rifillonin prej aty, mendoj se do të ishte një moment i madh për ne".

KËRKOHET DORËHEQJA E ABDIXHIKUT NGA DREJTIMI I LDK-së

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, nuk ka dhënë shenja për dorëheqje nga pozita e shefit të partisë. Duke injoruar kërkesat e tri degëve më të mëdha të kësaj partie, ai ka kritikuar kryetarët e tyre duke i quajtur sabotues. “Unë çështjen e dorëheqjes sime e kam trajtuar në Kuvendin e 31 janarit. Edhe përballë këtyre dy kryetarëve. Anëtarësia jonë, për mua, ka folur qartë. Por, për performancën e dobët në këto dy degë, rezultatin më të ulët ndër vite, pres dorëheqjet morale të dy kryetarëve në fjalë. I pranoj menjëherë. E siguroj anëtarësinë e gjerë të LDK-së se nuk do të lejojmë, që projektet e ndarjeve të LDK-së nga sabotues të qëllimshëm, të marrin formë. Ato dështuan më 31 janar; dështuan në zgjedhje, do të dështojnë edhe tash. Që nga atëherë, me të gjitha pengesat e dyshimet, në një kohë aq të shkurtër, ne megjithatë u rritëm. Sot, në asnjë rrethanë, me asnjë çmim, nuk do të lejojmë që vullneti i shumicës së LDK-së të tjetërsohet në projekte që synojnë ndarjen dhe më pas shuarjen e LDK-së”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.

Pas kërkesave për dorëheqje nga dega e LDK-së në Pejë, Lipjan, dhe dega e dytë në Prishtinë, dorëheqjen ia ka kërkuar të mërkurën edhe



Hykmete Bajrami, një nga figura kryesorë të kësaj partie. “Zgjedhjet e brendshme janë zgjidhja, të sillemi me dinjitet, sepse pozitat nuk janë të përhershme. E kam thënë edhe në janar se në LDK

përgjegjësia politike nuk mund të jetë selektive dhe se pas një rezultati të rëndë zgjedhor, duhet të ketë reflektim, përgjegjësi dhe zgjedhje të brendshme. Atëherë kam kërkuar

dorëheqjen e kryetarit dhe kam dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares, sepse besoja dhe vazhdoj të besoj se standardet duhet të vlejnjë për të gjithë. Parimi që kush humb

merr përgjegjësinë dhe lëshon rrugë duhet të zbatohet pa përjashtim”, ka thënë Bajrami. Një ditë më parë tri degë ia kanë kërkuar dorëheqjen kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku. Fillimisht Dega e LDK-së në Pejë kërkoj reflektim politik dhe përgjegjësi nga lidershipi. Pas analizës së rezultatit zgjedhor, Kryesia e kësaj degë deklaroi se “me shumicë votash” ka kërkuar dorëheqjen e udhëheqjes. “Në këtë drejtim, është kërkuar dorëheqja si akt moral dhe politik, duke vlerësuar se përgjegjësia për rezultatin duhet të bartet nga udhëheqja”, thuhej në reagimin e degës së Pejës. Më pas, me një deklaratë të gjatë dhe të argumentuar politikisht, Dega e LDK-së në Lipjan kërkoj drejtpërdrejt dorëheqjen e Abdixhikut. Kryesia e kësaj degë vlerësoi se rezultati zgjedhor në nivel vendi nuk mund t’u atribuohet vetëm strukturave lokale. “Kryesia e Degës vlerëson se rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme në nivel vendi nuk mund t’u atribuohet vetëm strukturave lokale. Ai paraqet edhe një reflektim të gjendjes, organizimit, funksionimit dhe kapacitetit politik të partisë në nivel qendror”, thuhej në deklaratë. Dorëheqjen Abdixhikut ia ka kërkuar edhe Dega e Dytë e LDK-së në Prishtinë.

ENDRIT THAÇI TAKON EDI RAMËN: FALEMINDERIT QË QËNDRUAT NË ANËN E SË VËRTETËS KUR SHUMË TË TJERË ZGJODHËN HESHTJEN



Tiranë, 24 qershor - Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka publikuar të mërkurën një fotografi nga takimi me kryeministrin e Shqipërisë, Edi

Rama, duke e falënderuar për mbështetjen e tij ndaj luftës së UÇK-së dhe ish-krerëve të saj që po përballen me procesin gjyqësor në Hagë. Në rrjetet sociale, Endrit Thaçi e

cilësoi Ramën një nga zërat më të fuqishëm në mbrojtje të luftës së UÇK-së dhe të së vërtetës për Kosovën. Ai shkroi se kryeministri shqiptar ka qëndruar në anën e së vërtetës

në një kohë kur, sipas tij, shumë të tjerë kanë zgjedhur të heshtin. Endrit Thaçi është takuar edhe me kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. “Një

kafe sot në Tiranë me Endrit Hashim Thaçin. Shpresojo shumë sot një muaj ta kemi edhe presidentin Thaçi mes nesh”, ka shkruar Balla në “Facebook”.

GAP-i: Numri i të angazhuarve me kontrata për shërbime të veçanta në komuna u rrit për rreth 40 për qind brenda një viti

Prishtinë, 24 qershor - Instituti GAP ka bërë me dije se numri i personave të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta në komunat e Kosovës është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2025 krahasuar me vitin paraprak. Sipas të dhënave të

publikuara nga instituti, numri total i kontratave për shërbime të veçanta ka arritur në 534 gjatë vitit 2025, nga 381 sa ishte në vitin 2024, duke shënuar rritje rreth 40 për qind.

GAP ka sqaruar se emërimet me afat të caktuar për

periudha më të shkurtra se gjashtë muaj realizohen përmes të ashtuquajturave "Marrëveshje për shërbime të veçanta", të cilat i nënshtrohen Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe zbatohen përmes një procedure të

thjeshtëzuar rekrutimi. Sipas analizës, rritjen më të madhe e ka shënuar komuna e Prishtinës, ku numri i të angazhuarve me këto kontrata është rritur nga 73 në 207, ose 134 më shumë se një vit më parë.



GUVERNATORI ISMAILI: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE EDUKIMI FINANCIAR MBETEN NDËR PRIORITETET STRATEGJIKE TË BQK-SË

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatoren Nesrin Shileku-Shala dhe bashkëpunëtorë, pritë në takim Misionin e Asistencës Teknike të Bankës Botërore, të financuar nga SECO, i cili po mbështet BQK-në në procesin e avancimit të mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar.

Misioni udhëhiqet nga Oya Ardic Pinar Alper dhe Sergio Jose De Mesquita Gomes, Specialistë të Lartë të Sektorit Financiar nga Global Financial Services Sector, së bashku me kolegë.

Gjatë takimit me Misionin u diskutua për bashkëpunimin me



Bankën Botërore, me qëllim avancimin e mëtejshëm të kornizës së BQK-së për mbrojtjen e konsumatorit financiar dhe edukimin financiar, si fusha me rëndësi strategjike për forcimin e besimit, transparencës dhe

qëndrueshmërisë së sektorit financiar.

Ky angazhim synon ta mbështesë zhvillimin e qasjeve moderne, të përafuara me praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes së praktikave dhe

sjelljes në treg, mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar, duke kontribuar në forcimin e rolit të BQK-së në promovimin e një sektori financiar të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt qytetarëve.

Guvernatori Ismaili theksoi se mbrojtja e konsumatorit dhe edukimi financiar mbeten ndër prioritetet strategjike të BQK-së, duke shërbyer për rritjen e njohurive financiare të qytetarëve, promovimin e përfshirjes financiare dhe forcimin e vendimmarrjes së mirinformuar financiare.

BQK-ja synon të sigurojë që kornizatet dhe instrumentet e reja në këto fusha të zhvillohen në

përputhje me rekomandimet e OECD/INFE, kornizatet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe standardet e tjera ndërkombëtare, duke reflektuar një qasje moderne, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur me nevojat e tregut financiar të Kosovës.

Në përfundim të takimit, guvernatori Ismaili shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të Bankës Botërore dhe SECO-s, si dhe rikonfirmoi përkushtimin e BQK-së për avancimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar, si pjesë e përpjekjeve më të gjera për forcimin e stabilitetit, integritetit dhe besimit në sektorin financiar.

QEVERIA MIRATON FINANCIMIN E KATËR PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE NË MITROVICË, FUSHË-KOSOVË, GRAÇANICË DHE OBILIQ

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar të mërkurën financimin e katër projekteve infrastrukturore në komunat Mitrovicë, Fushë-Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës lokale dhe kushteve për qytetarët.

Lajmin e bëri me dije ministri në detyrë i Infrastrukturës, Dimal Basha, i cili njoftoi se me

vendimin e sotëm të qeverisë është mundësuar alokimi i mjeteve financiare për realizimin e këtyre investimeve. Sipas Bashës, në komunën e Mitrovicë do të investohen 500 mijë euro për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Bajgorë, Rashan, Terstenë, Kutlofc dhe Vllahi. Ndërkaq në Fushë-Kosovë do të financohet rehabilitimi i segmentit të rrugës "Agron Rrahmani", në kuadër të një



projekti të përbashkët me komunën e Graçanicë.

Për Graçanicën është paraparë financimi i rehabilitimit të rrugës Uglari, po ashtu në kuadër të projektit të përbashkët me Fushë-Kosovën, me vlerë totale prej 200 mijë eurosh.

Ndërkohë, në komunën e Obiliqit do të investohen 450 mijë euro për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrugës që lidh Plemetin me Hamidinë dhe

Sibocin, si dhe për ndërtimin e sistemit të ndriçimit publik.

Ministri Basha tha se këto investime do të ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës lokale, rritjen e sigurisë në komunikacion dhe krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e këtyre komunave. Ai theksoi se qeveria do ta vazhdojë mbështetjen për komunat dhe zhvillimin e projekteve që përmirësojnë jetën e qytetarëve.

KEDS-I GJOBITET 25 MIJË EURO PËR PËRDORIM TË NJEHSORËVE ME AFAT TË SKADUAR VERIFIKIMI



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përmes Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK) dhe Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ka vazhduar aktivitetet e mbikëqyrjes dhe verifikimit të njëhsorëve elektrikë në territorin e Republikës së Kosovës.

Gjatë kontrolleve të realizuara së fundmi janë identifikuar edhe pesë (5) njëhsorë elektrikë me afat të skaduar të verifikimit metrologjik, për çka ndaj operatorit ekonomik KEDS është shqiptuar gjobë në vlerë prej 25 mijë eurosh.

MINTI dhe AMK theksojnë se verifikimet do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, me qëllim të

garantimit të matjes së saktë të konsumit të energjisë elektrike, mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve dhe respektimit të standardeve ligjore dhe metrologjike në fuqi.

Institucionet përgjegjëse mbeten të përkushtuara për të siguruar që çdo njëhsor elektrik në përdorim të jetë i verifikuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore,

duke garantuar transparencë dhe besueshmëri në procesin e matjes së energjisë elektrike.

MINTI u bënë thirrje të gjithë konsumatorëve që kanë dëshmi apo dyshime lidhur me funksionimin e njëhsorëve elektrikë të vazhdojnë t'i adresojnë ankesat dhe informacionet e tyre te kjo ministri.

Shënohet 24 Qershori, Dita Memoriale e Komunitetit Egjiptian

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryeministri në detyrë Albin Kurti ka organizuar pritje në Ballkonin e Hapur të Qeverisë me rastin e shënimit të 24 Qershorit, Ditës Memoriale të Komunitetit Egjiptian. Në fjalën hyrëse, ai tha se ditët memoriale janë më

emocionuese se ditët festive dhe janë më të veçanta se ditët e zakonshme, ngaqë ato janë rikujtim për rrugëtimin dhe ritheksimin për rëndësinë e rolin e komunitetit egjiptian, i cili ka ecur mes kohëve, mes stuhive dhe nuk ka lejuar kurrë që ta humbasë

drejtimin.

Kryeministri në detyrë, Kurti, theksoi se në çdo hap të rrugëtimin tonë shtetndërtues, nga përpjekjet e hershme për liri e shpallja e pavarësisë e deri te funksionimi i institucioneve demokratike, komuniteti egjiptian ka qenë pjesë e pandarë e historisë sonë.



'NË KOSOVË NDIHESH SI NË FAMILJE': TURISTËT ZBULOJNË 'PERLËN E FSHEHUR' MES MALEVE TË BALLKANIT

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Tri vjet më parë, kur Mariusz Zaremba dhe miqtë e tij vendosën të niseshin drejt Ballkanit për të përshkuar shtegun malor "Peaks of the Balkans" (shqip: Majat e Ballkanit), pritjet e tyre për Kosovën nuk ishin të mëdha.

Për vite me radhë, polaku - që tash jeton në Irlandë - kishte eksploruar Alpet, Dolomitet dhe malet e tjera të Evropës Perëndimore. Por, turizmi malor atje nisi t'i dukej gjithnjë e më komercial.

Kur dëgjoi për herë të parë për Ballkanin si destinacion për ecje malore, fillimisht ishte skeptik. "Ballkani - ish-Jugosllavia - më bënte të mendoja për varfëri, luftë dhe një atmosferë të zymtë sovjetike. Përshtypja ime e parë bazohej në injorancë dhe stereotipa", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Në atë kohë, kujton Zaremba, shumë udhërrëfyes dhe artikuj për shtegun rekomandonin që Kosova të anashkalohej. Por, pikërisht këto këshilla shtynë atë dhe miqtë e tij të bëheshin edhe më kureshtarë për ta parë vendin nga afër. Ata e nisën udhëtimin në Mal të Zi, ku gjetën peizazhe të bukura dhe shtigje relativisht mirë të shënuara, por me pak kontakt me banorët lokalë.

Në Shqipëri, sipas tij, natyra ishte ndoshta më mbresëlënëseja përgjatë gjithë shtegut por, gradualisht, nisi të ndihej prania e turizmit masiv, me vila që po ndërtoheshin përgjatë gjithë shtegut. "Dhe, më në fund, erdhi Kosova. Male më të buta, më shumë pyje, lule dhe gjelbërim dhe më e rëndësishmja: qetësi dhe paqe totale", kujton Zaremba. Por, ajo që e veçoi Kosovën, sipas tij, nuk ishte vetëm natyra. "Njerëzit ishin miqësorë kudo... Ndihehim sikur po vizitonim familjarë dhe jo thjesht si turistë".

Ai thotë se në shumë destinacione të njohura evropiane është ndier thjesht "si një klient tjetër", ndërsa në Kosovë ka gjetur ngrohtësi të sinqertë dhe mikpritje.

Pikërisht kjo përvojë bëri që ai të kthehej një vit më vonë dhe të planifikojë edhe një tjetër vizitë këtë vit - kësaj radhe vetëm në Kosovë. "Kosova është një perlë e fshehur", thotë Zaremba. "Ende relativisht e paprekur dhe jo e prishur nga dora e njeriut". Sipas tij, potenciali i Kosovës nuk është shfrytëzuar ende plotësisht.

Ai thotë se shtigjet nuk janë gjithmonë mirë të shënuara dhe se sinjali telefonik është shpesh i dobët, ndërsa në disa pjesë edhe asfaltimi i rrugëve ka zbehur ndjesinë e natyrës së paprekur.

Kosova, sipas tij, duhet të ketë kujdes të mos ndjekë gabimet e disa vendeve të rajonit, veçanërisht komercializimin e tepruar, në mënyrë që ta ruajë dhe shfrytëzojë më mirë potencialin e saj turistik.

Në malet e Kosovës, Safet Behrami e sheh këtë potencial nga afër.

I licencuar si guidë malore dhe aktiv prej vitesh në shtigjet e "Peaks of the Balkans" dhe "High Scardus Trail", ai thotë se interesimi i turistëve është rritur vazhdimisht.

Behrami thotë se, vitet e fundit, ka shoqëruar turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Izraeli dhe vende të tjera të largëta.

Përveç shtigjeve malore, Kosova tërheq vizitorë edhe për trashëgiminë e saj kulturore dhe historike. Prizreni konsiderohet gjerësisht kryeqendra kulturore e vendit dhe një nga destinacionet më të vizituara nga turistët e huaj, ngjashëm si monumenti Newborn në Prishtinë që është bërë simbol i pavarësisë së vendit.

Ndërsa Gryka e Rugovës, Bjeshkët e Nemuna, Malet e Sharrit dhe Brezovica janë ndër atraksionet kryesore natyrore. Megjithatë, sipas Behramit, Kosova vazhdon të mbetet në hije krahasuar me Shqipërinë dhe Malin e Zi. "Fatkeqësisht, turistët shpesh e evitojnë pjesën e Kosovës", thotë ai, duke shtuar se një nga arsyt kryesore është



mungesa e promovimit ndërkombëtar. "Kur i kam pyetur turistët se si kanë vendosur të vijnë në Shqipëri ose Mal të Zi, shumë prej tyre më kanë treguar se i kanë parë këto destinacione në televizionet kombëtare të vendeve të tyre", thotë Behrami për Radion Evropa e Lirë.

Ai thotë se në grupet online të dedikuara për "Peaks of the Balkans" shpesh shihen itinerare që e anashkalojnë Kosovën, edhe pse vizitorët që e përfshijnë vendin, zakonisht largohen me përshtypje pozitive. "Secili prej tyre bën apel që të mos evitohet pjesa e Kosovës. Thonë se është shumë e bukur", tregon Behrami.

Në qeverinë e formuar këtë vit, e që aktualisht është qeveri në detyrë, për herë të parë është ndarë Ministria e Kulturës dhe Turizmit nga ajo e Rinisë dhe Sportit, duke krijuar një institucion të veçantë me

mandat të dedikuar për zhvillimin e turizmit.

Në përgjigjen e dhënë për Radion Evropa e Lirë, ministria thotë se kjo ndarje institucionale tregon përkushtimin më të madh të qeverisë për ta trajtuar turizmin si sektor më vete dhe për ta forcuar zhvillimin e tij. Megjithatë, ajo pranon se sfidat mbeten të shumta, duke filluar nga infrastruktura dhe kapacitetet akomoduese, deri te fuqia punëtore, promovimi ndërkombëtar dhe zgjatja e sezonit turistik gjatë gjithë vitit. "Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe pushtetin lokal, synohet zgjerimi i rrjetit të shtigjeve që lidhin destinacionet kryesore turistike dhe krijimi i standardeve më të larta për sigurinë dhe shërbimet për vizitorët", thuhet në përgjigje.

Por, në terren, sfida e kapaciteteve akomoduese del shpesh si pengesë konkrete për

zhvillimin e turizmit malor. "Ka turistë që anulojnë udhëtimet sepse nuk gjejnë vend për të fjetur", thotë Behrami. Sipas tij, kjo tregon edhe potencialin e pashfrytëzuar ekonomik të zonave malore, ku zhvillimi i turizmit mund të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për komunitetet lokale.

Për turistë si Mariusz Zaremba, pikërisht ky autenticitet mbetet një nga asetet më të mëdha të Kosovës. "Në Kosovë gjej atë që ndonjëherë më mungon: male, pyje, ushqim të vërtetë shtëpiak dhe një mikpritje që të bën të ndihesh pothuajse si pjesë e familjes. Ky është ndoshta komplimenti më i madh që mund t'i japësh një vendi të huaj dhe njerëzve të tij", përfundon ai.

Ministria shton se planifikimi i destinacioneve dhe përfshirja e komuniteteve lokale mbeten kyç për suksesin afatgjatë të sektorit të turizmit.

Ethem Çeku promovon librin "Lëvizja shqiptare për pavarësi", një studim mbi rrugën drejt shtetit shqiptar



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Ish-ministri dhe historiani Ethem Çeku ka promovuar të mërkurën në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" librin më të ri, "Lëvizja shqiptare për pavarësi - politika, kryengritjet dhe diplomacia (1908-1912)".

Përmes këtij botimi autori sjell një vështrim të thelluar mbi

një nga periudhat më të rëndësishme të historisë kombëtare shqiptare.

Libri trajton zhvillimet politike, kryengritjet dhe aktivitetin diplomatik të shqiptarëve në vitet vendimtare që i paraprinë shpalljes së pavarësisë. Sipas autorit, pikërisht gjatë kësaj periudhe patriotët shqiptarë, përmes organizimit politik,

kryengritjeve dhe forcimit të ndërgjegjes kombëtare, kurorëzuan përpjekjet shekullore për formimin e shtetit shqiptar.

Në ceremoninë e promovimit morën pjesë intelektualë, profesorë universitarë, përfaqësues të jetës politike si dhe miq dhe bashkëpunëtorë të afërt të autorit.

BEHGJET PACOLLI KËRKON NDËRHRYJE URGJENTE TË PROKURORISË PËR BLOKADAT NË AEROPORTIN E VLORËS

VLORË, 24 QERSHOR - Afaristi Behgjet Pacolli i është drejtuar publikisht Prokurorit të Shtetit në Vlorë, duke kërkuar ndërhyrje urgjente lidhur me bllokimin e qasjes në Aeroportin e Vlorës. Përmes një reagimi në "Facebook", Pacolli thotë se kamionët e Valon Ademit jo vetëm që kanë bllokuar hyrjen në aeroport, por kanë uzurpuar edhe rrugën publike të fshatit, duke penguar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Ai e cilëson situatën si skandaloze, duke pretenduar se ngjarja po zhvillohet në prani të Policisë së Shtetit, e cila, sipas tij, ndodhet vetëm pak metra larg vendit të ngjarjes. Pacolli thotë se denoncimet për bllokadat dhe, sipas tij, paligjshmëritë ndaj investitorit



dhe shtetit janë dorëzuar vazhdimisht në institucionet përkatëse, por se deri më tani nuk ka pasur veprime konkrete. "Drejtuar Prokurorit të Vlorës! I nderuari Prokuror i shtetit! Ky është realiteti i hidhur: kamionët e Valon Ademit jo vetëm që kanë bllokuar hyrjen dhe qasjen në arealin e aeroportit, por kanë uzurpuar edhe rrugën PUBLIKE të fshatit, duke penguar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Më skandalozja është se kjo ndodh nën sytë e Policisë së Shtetit, e cila ndodhet vetëm pak metra larg dhe, në vend që të zbatojë ligjin, po toleron dhe po mbron këtë paligjshmëri të hapur. Kur institucionet që duhet të garantojnë rendin dhe ligjin

bëhen spektatore ose mbrojtëse të shkeljeve, atëherë kemi të bëjmë me një precedent të rrezikshëm për shtetin e së drejtës. I nderuari prokuror i Shtetit! Çdo ditë ju keni përpara denoncimet tona për dhunën dhe paligjshmërinë që një grup i organizuar ushtron ndaj investitorit dhe ndaj vetë shtetit. Çdo ditë i shihni edhe këto pamje e këto bllokada. Çfarë duhet të bëjmë më tepër? Ne nuk kemi zgjedhur dhe nuk do të zgjedhim dhunën. Kemi besuar te ju, te ligji dhe te drejtësia. Prandaj, ose veproni sipas ligjit, ose dilni dhe deklarohuni qartë: si duhet të veprojmë kur ligji nuk na mbron Mos pritni përshkallëzim tjetër ju lutem!", ka shkruar Pacolli.

KOSOVA IMPORTOI 638.6 MILIONË EURO MALLRA NË MAJ, EKSPORTET MBULOJNË VETËM 14.7 % TË IMPORTETEVE

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin maj 2026. Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një rritje të deficitit tregtar prej 4 % në muajin maj 2026, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025, gjegjësisht në vlerë prej 544,4 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 523,4 milionë eurosh në vitin 2025. Eksporti mbulon importin me 14,7 %. Eksporti i mallrave në muajin maj 2026 kishte vlerën 94,1 milionë euro, ndërsa importi 638,6 milionë euro, që është një rritje prej 15,7 % për eksport, si dhe një rritje prej 5,6 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 27,5 % e përbëjnë metalet bazë dhe

artikujt prej tyre; 11,1 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10,7 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 8,9 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 8 % e përbëjnë produktet minerale etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 15,2 % e përbëjnë produktet minerale, 12,6 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 12 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,7 % e përbëjnë mjetet e transportit; 10,8 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 30,8 milionë euro, ose rreth 32,7 % e eksporteve të përgjithshme, me



një rritje prej 6,3 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9,9 %), Italia (4,9 %), Holanda (2,7 %) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 301,3 milionë euro, ose 47,2 % e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 13,7 %. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13,1 %), Italia

(8,8 %), Polonia (4,1 %) etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 43,1 milionë euro, ose 45,7 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 24,6 %. Partnerët kryesorë për

eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (16,4 %), Shqipëria (14,8 %), Mali i Zi (6,6 %), Serbia (6,4 %) etj. Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 85,3 milionë euro, ose 13,4 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 22,5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (4,9 %), Shqipëria (4,1 %), Serbia (3,2 %).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 20,3 milionë euro, ose 21,6 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (10,6 %) dhe Turqia (4,5 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 252 milionë euro, ose 39,5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (12,2 %) dhe Turqia (13,9 %).

AKB-ja: KOSOVA NUK DUHET TA HUMBASË MUNDËSINË HISTORIKE TË PARTNERITETIT ENERGJETIK ME SHBA-në

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka vlerësuar se Republika e Kosovës duhet të vazhdojë ta ndërtojë të ardhmen e saj ekonomike, energjetike dhe zhvillimore në partneritet të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "ShBA-të ishin çlirimtarët e Kosovës, mbështetëset vendimtare të shtetndërtimit dhe aleatet kryesore të integritit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Për këtë arsye, çdo projekt strategjik që vjen nga partneri ynë më i madh strategjik duhet të trajtohet me përgjegjësi të lartë shtetërore dhe me vizion afatgjatë. AKB-ja konsideron se investimet në infrastrukturën energjetike, të cilat mundësojnë

qasje në gazin natyror të lëngshëm (LNG) nga ShBA-të, përfaqësojnë një mundësi historike për forcimin e sigurisë energjetike, rritjen ekonomike dhe modernizimin e sektorit energjetik të Kosovës", ka thënë Shahini.

Ai ka theksuar se përfitimet e këtij projekti do të ishin të shumta. "Ulja e varësisë nga importet e kushtueshme të energjisë elektrike, rritja e sigurisë dhe stabilitetit energjetik për qytetarët dhe bizneset, mbështetja e tranzicionit energjetik dhe integritit të burimeve të ripërtërishe, përgatitja e industrisë së Kosovës për standardet evropiane lidhur me emetimet e karbonit, tërheqja e investimeve të reja amerikane



dhe krijimi i vendeve të reja të punës si dhe forcimi i partneritetit ekonomik dhe strategjik ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së", ka thënë ai. Shahini ka theksuar se AKB-ja

beson fuqishëm se Kosova nuk duhet të pozicionohet kundër projekteve strategjike amerikane, por të bashkëpunojë ngushtë me aleatin e saj më të madh për të siguruar zhvillim

ekonomik të qëndrueshëm, siguri energjetike dhe mirëqenie për qytetarët. "Ne u bëjmë thirrje institucioneve të Republikës së Kosovës që vendimet për projektet energjetike strategjike të mos udhëhiqen nga kalkulime politike afatshkurtra, por nga interesat afatgjatë shtetërore, ekonomike dhe kombëtare. Miqësia me Amerikën nuk është vetëm pjesë e historisë sonë të lavdishme. Ajo mbetet garancia më e fuqishme për të ardhmen, sigurinë dhe zhvillimin e Kosovës. Prandaj, projektet që forcojnë partneritetin ekonomik, energjetik dhe strategjik me ShBA-në duhet të konsiderohen interes kombëtar i Republikës së Kosovës", ka deklaruar Shahini.

DHJETË VJET PAS BREXIT-it, LONDRA DHE BERLINI PO AFROHEN



Kur rezultatet e referendumit të Mbretërisë së Bashkuar u shpallën në mëngjesin e 24 qershorit 2016, një valë mosbesimi u përhap në të gjithë Bashkimin Evropian (BE), dhe veçanërisht në Gjermani. Pothuajse 52 përqind e votuesve britanikë votuan për t'u larguar nga BE, ndërsa 48 përqind votuan kundër.

Ish-Ministri i Jashtëm gjerman, Presidenti i tanishëm Frank-Walter Steinmeier, e quajti rezultatin një "katastrofë", ndërsa ish-Kancelarja Angela Merkel foli për një "goditje të rëndë për Evropën".

Dështon marrëveshja SHBA-Iran? Mijëra anije tregtare mbeten të bllokuara në Gjirin Persik

Vetëm një pakicë në Gjermani e priste një rezultat të tillë. Shumica e politikanëve dhe gazetarëve e konsideronin të paimagjinueshme idenë që një vend të largohet vullnetarisht nga Bashkimi Evropian dhe kështu të hiqte dorë nga përfitimet e tregut të përbashkët evropian. Në Gjermani, në veçanti, fushata britanike për të "marrë përsëri kontrollin", e udhëhequr nga politikanë konservator Boris Johnson, u nënvlerësua.

Brexitistët donin të merrnin kontrollin mbi imigracionin në vend. Si përfundim, rezultati i referendumit kishte një dimension të qartë gjerman. Politika e kufijve të hapur e Kancelares Merkel që nga shtatori 2015 ka bërë që

migrantët e natyralizuar të kenë fituar automatikisht të drejtën për të banuar në Mbretërinë e Bashkuar.

"Politika e migracionit ishte një nga faktorët kryesorë që ndikoi në vendimin për Brexit", thotë Christophe Fricker i Universitetit të Bristolit, i cili ka botuar gjerësisht mbi Brexit-in. Por ai gjithashtu thekson "ironinë që pas Brexit-it, numrat e imigracionit janë rritur ndjeshëm përsëri, vetëm se këta nuk janë më qytetarë të shteteve anëtare të BE-së".

Pas vite të shumta negociatash, Mbretëria e Bashkuar u largua zyrtarisht nga Bashkimi Evropian më 31 janar 2020. "Ndarja" përfundimtare nga tregu i vetëm dhe bashkimi doganor mori formën e prerë më 1 janar 2021. Ndryshimi është veçanërisht i dukshëm në tregtinë midis Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Sipas Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë, tregtia ka rënë ndjeshëm që nga Brexit. Ndërsa Mbretëria e Bashkuar ishte partneri i pestë më i rëndësishëm tregtar i Gjermanisë në vitin 2016, tani është në vendin e nëntë. Por sipas Christoph Fricker, Gjermania nuk ka humbur vetëm një partner të fortë tregtar.

"Ajo që është humbur është një partner i fortë në fushën e mbrojtjes. Kjo është pikërisht fusha ku bashkëpunimi po fillon përsëri. Përveç kësaj, janë humbur miq. Kishte një lidhje shumë të ngushtë ndërpersonale

dhe socio-civile. Sot, është më e dobët dhe më e vështirë për t'u ruajtur."

Fricker shton se midis të rinjve gjermanë, Mbretëria e Bashkuar që atëherë është "zhdukur nga radari".

Por procesi i riafrimit ka kohë që ka filluar. Tregtia gjermano-britanike rregullohet nga Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit midis Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Bashkuar, dhe për këtë arsye nuk është përgjegjësi e qeverive të shteteve anëtare individuale të BE-së.

Të dy vendet janë afruar edhe në nivel bilateral, kryesisht përmes dy marrëveshjeve që përqendrohen në partneritetin në mbrojtje. Procesi filloi me Marrëveshjen e Trinity House, të nënshkruar në tetor 2024, e cila forcoi bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes. Bashkëpunimi u zgjerua më tej në korrik 2025 nga Marrëveshja e Kensington, një traktat miqësie që synonte një thellim të përgjithshëm të marrëdhënieve britaniko-gjermane.

Një moment i rëndësishëm për marrëdhëniet dypalëshe pas Brexit ishte edhe vizita shtetërore tre-ditore e Mbretit Charles III në Berlin dhe Hamburg në maj 2023. Gjatë vizitës, Charles mbajti fjalimin e parë nga një monark britanik në Bundestagun gjerman, pjesërisht në gjermanisht.

Dy politikanë nga familje të ndryshme politike janë

aktualisht në krye të dy qeverive: Keir Starmer (kryeministër në dorëheqje) vjen nga Partia Socialdemokrate e Punës, dhe Friedrich Merz nga CDU konservatore.

Pavarësisht kësaj, ata kanë shumë të përbashkëta, sipas Linn Selle nga Shoqata Gjermane për Politikë të Jashtme.

"Starmer, ashtu si Merz, është pragmatist. Të dy janë të lidhur nga një mbështetje e fortë për Ukrainën", tha Selle për DW. "Merz, gjithashtu i formuar fort nga mjedisi politik anglo-sakson, e ka ndjekur nga afër Brexit-in dhe sigurisht dëshiron një lidhje më të ngushtë politike midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian".

Fricker shton: "Ajo që i lidh ata është mënyra klasike e të menduarit të qendrës politike, e cila ndoshta ishte vendimtare për të dy gjatë fushatave zgjedhore. Fatkeqësisht, ata janë të lidhur edhe nga një paqartësi e caktuar në qasje".

Sipas tij, Merz shpesh nuk zbaton gjërat pas fjalimeve politike, ndërsa Starmer nuk ka udhëheqje të qartë në situatën aktuale të krizës ndërkombëtare. Një referendum i ri për BE-në nuk është problem.

Merz dhe Starmer po përballen me presion nga e djathta, si dhe nga partitë e tyre. Në Mbretërinë e Bashkuar, sipas sondazheve, partia Reform UK, e udhëhequr nga Nigel Farage, e ka tejkaluar ndjeshëm Partinë Laboriste, ndërsa në Gjermani AfD ka

tejkalar CDU/CSU-në. Farage ishte një nga nxitësit kryesorë të daljes nga BE-ja, dhe AfD gjithashtu mban një qëndrim shumë skeptik ndaj Bashkimit Evropian. Starmer njoftoi dorëheqjen nga posti i tij si kreu i qeverisë në Londër të hënën (22 qershor) për shkak të presionit politik të brendshëm.

Linn Selle beson se ndikimi i politikanëve të huaj në situatën politike në Mbretërinë e Bashkuar nuk duhet të mbivlerësohet.

"Por nuk ka dyshim se do të jetë në interesin e Merz të forcojë zërin pro-evropian në Mbretërinë e Bashkuar përmes afrimit pragmatik me Bashkimin Evropian."

"Kohët e fundit ka pasur një ndryshim trendi në sondazhe dhe duket se shumica ishte për qëndrim në BE. Kjo shumicë po bëhet gjithnjë e më e qëndrueshme", thotë Fricker. "Shumë njerëz këtu e kanë kuptuar se dalja nuk ishte një ide e mirë dhe i dëmtoi ata."

Por asnjë politikan kryesor britanik nga partitë kryesore nuk ka nisur ndonjë projekt konkret në këtë drejtim. Prandaj, qeveria gjermane duhet të jetojë me situatën ekzistuese dhe në të ardhmen duhet të përipiqet që së bashku me britanikët, të bëjë më të mirën në kushtet e tanishme – për sa kohë në Londër nuk ka ndonjë qeveri që do të rikthehet në BE./DW

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

TRUMPI, ROL KRYESOR NË FINALEN E BOTËRORIT

NEW JERSEY, 24 QERSHOR - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka zbuluar se Donald Trumpi pritet të ketë rol të veçantë në finalen e Kupës së Botës, e cila do të zhvillohet më 19 korrik në New Jersey. Në një paraqitje në "Fox News", Infantino ka deklaruar se presidenti i Shteteve të Bashkuara do të jetë pjesë e ceremonisë së dorëzimit të trofeut për fituesin e turneut.

Trumpi ende nuk është shfaqur në stadium gjatë këtij Botërori për ta ndjekur kombëtaren amerikane, e cila ka fituar dy ndeshjet e para në turneun që po zhvillohet në

shtëpi. Ai mungoi edhe në ndeshjen hapëse të ShBA-së ndaj Paraguait, të cilën amerikanët e fituan 4-1, pasi ishte duke u përgatitur për një paraqitje në eventin UFC Freedom 250 në Shtëpinë e Bardhë, organizuar për 250-vjetorin e Shteteve të Bashkuara.

Sipas Infantinos, Trumpi pritet të jetë i pranishëm në finalen e Botërorit dhe të ketë rol të rëndësishëm në ceremoninë përmbyllëse. "Do të jemi së bashku me presidentin duke e shijuar finalen dhe, natyrisht, duke ia dorëzuar trofeun fituesit", ka thënë Infantino. Kjo do të



nënkuptonte që Trumpi pritet të marrë pjesë në dorëzimin e trofeut dhe në festimet e ekipit kampion, ngjashëm me rolin që pati edhe gjatë ceremonisë së Kupës së Botës për Klube, kur

Chelsea ishte shpallur fituese. Ky veprim do të përbënte një ndryshim nga tradita e viteve të fundit, pasi as presidenti rus, Vladimir Putin në vitin 2018 dhe as Emiri i Katarit, Sheikh

Tamim bin Hamad Al Thani në vitin 2022, nuk kishin rol të drejtpërdrejtë në dorëzimin e trofeut kur fituan Franca dhe Argjentina.

Infantino mund ta konsiderojë këtë si një moment të përshtatshëm, duke qenë se Trumpi është mbajtësi aktual i një çmimi të FIFA-s. Presidenti amerikan është bërë personi i parë që ka marrë këtë çmim, pasi i ishte dorëzuar në dhjetor të vitit të kaluar.

Finalja e Kupës së Botës pritet të zhvillohet më 19 korrik në New Jersey, ku fituesi do të kurorëzohet kampion bote në një ceremoni ku Trumpi pritet të jetë ndër figurat kryesore.

SITUATË E PAZAKONTË NË KUPËN E BOTËS: PËR AUSTRI NË DHE ALGJERINË HUMBJA MUND TË JETË MË E FAVORSHME SE FITORJA

NYU-JORK, 24 QERSHOR - Fitorja në Kupën e Botës duhet të jetë synimi i çdo kombëtareje, por në edicionin 2026 po shfaqet një situatë e pazakontë ku humbja mund të rezultojë më e favorshme se fitorja për vazhdimin e garës. Kupa e Botës 2026 është e para me 48 ekipe, të ndara në 12 grupe me nga katër skuadra. Ndryshe nga formatet e mëparshme, ku dy ekipet e para kalonin tutje, tani në fazën eliminatorë avancojnë 32 skuadra, përfshirë tetë vendet e treta më të mira. Një nga ndeshjet më



interesante të fazës së grupeve është ajo në mes të Austrisë dhe Algjerisë. Të dyja kombëtalet kanë nga tri pikë dhe do të hyjnë në ndeshjen e fundit duke e

ditur saktësisht se çfarë u nevojitet për kualifikim. Sipas skenarëve aktualë, një barazim mund t'i dërgojë të dyja ekipet në fazën eliminatorë. Megjithatë, situata bëhet edhe më interesante sepse humbësi i kësaj ndeshjeje ka gjasa të mëdha të kualifikohet si një nga vendet e treta më të mira. Dallimi qëndron te kundërshtari në fazën tjetër. Ekipi që përfundon i dyti në grup pritet të përballet me fituesin e Grupit H, ku favorite është Spanja, një nga pretendentet kryesorë për

titullin. Në anën tjetër, skuadra që kualifikohet si vend i tretë mund të përballet me kundërshtarë teorikisht më të përballueshëm, nga grupet D, B, G, L ose K. Kjo situatë rikujton të ashtuquajturin "Turpi i Gjonit" në Kupën e Botës 1982, kur Gjermania Perëndimore dhe Austria luajtën një ndeshje me rezultat 1-0 që ua siguronte të dyja skuadrave kualifikimin, duke eliminuar Algjerinë. Pas golit të hershëm të gjermanëve, të dy ekipet praktikisht ndalën sulmet, duke

administruar rezultatin deri në fund. Ndeshja u kritikua ashpër nga opinioni sportiv dhe konsiderohet si një nga episodet më të diskutueshme në historinë e futbollit.


Si pasojë e atij rasti, FIFA vendosi që ndeshjet e fundit të çdo grupi të zhvillohen në të njëjtën kohë, për t'i shmangur kalkulimet dhe marrëveshjet e mundshme mes skuadrave. Në Kupën e Botës 2026, megjithatë, formati i ri po krijon sërish skenarë të pazakontë, ku rruga drejt suksesit mund të kalojë edhe përmes një humbjeje.

RONALDO VENDOS REKORD HISTORIK NË KUPËN E BOTËS

FLORIDA, 24 QERSHOR - Cristiano Ronaldo ka hyrë edhe një herë në histori të futbollit botëror, duke vendosur një rekord unik gjatë Kupës së Botës 2026, të cilin as Lionel Messi nuk mund ta arrijë. Në ndeshjen e Portugalisë ndaj Uzbekistanit, sulmuesi 41-vjeçar ka shënuar golin e parë të takimit dhe ia ka dhënë avantazhin skuadrës së tij, duke regjistruar një moment historik në karrierën

e tij të jashtëzakonshme. Pastaj ka shënuar edhe një gol, duke çuar në 10 gola paraqitjet e tij në Kupat e Botës. Me këtë gol Cristiano Ronaldo është bërë lojtari i parë në histori që shënon në gjashtë edicione të ndryshme të Kupës së Botës, duke nisur nga Gjermania 2006 dhe duke vazhduar në çdo turne deri në vitin 2026.

Rruga e tij në Botëror ka filluar me golin ndaj Iranit në 2006,



duke vazhduar me realizime në Afrikën e Jugut 2010, Brazil 2014, Rusi 2018 dhe Katar

2022, ku ka shënuar gjithsej tetë gola.

Seria e tij është zgjatur edhe në Botërorin 2026, duke e bërë një nga rekordet më të qëndrueshme në historinë e futbollit ndërkombëtar.

Edhe pse Lionel Messi ka lënë gjurmë të jashtëzakonshme në Kupat e Botës dhe mban rekordin si golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve me 18 gola, ai nuk ka arritur të shënojë në gjashtë edicione të

ndryshme të turneut.

Messi ka realizuar në pesë Botërorë (2006, 2014, 2018, 2022 dhe 2026), por mosshënimi në një nga edicionet e mëparshme e bën të pamundur barazimin e këtij rekordi të Ronaldos. Në këtë mënyrë, Ronaldo dhe Messi vazhdojnë rivalitetin e tyre historik edhe në skenën më të madhe të futbollit, me rekorde që po e çojnë gjithnjë e më lart kufirin e historisë së sportit.

Bellingham mezi pret të punojë me Mourinon: Është trajner i madh

KANSAS CITY, 24 QERSHOR - Jude Bellingham ka folur pas barazimit pa gola të Anglisë ndaj Ganës në Kupën e Botës 2026, duke komentuar edhe ardhjen e José Mourinhos në stolin e Real Madridit. Mesfushori anglez nuk i ka kursyer fjalët e mira për

trajnerin portugez, duke e vlerësuar lart figurën e tij. "Mourinho është një trajner i madh", ka thënë Bellingham. Ylli i Anglisë dhe i Real Madridit është shprehur gjithashtu i kënaqur me lëvizjet e klubit në merkato, duke theksuar cilësinë dhe

përvojën që kanë sjellë afrimet e reja.

"Jam shumë i lumtur. Kemi bërë gjithashtu nënshkrime të shkëlqyera, shumë afrime, me shumë cilësi dhe përvojë. Do të jem shumë i lumtur të punoj me ta", ka përfunduar Bellingham.

Ndërkohë, ylli i "Tre Luanëve" aktualisht është i fokusuar tek objektivi për ta fituar Kupën e Botës 2026 me Anglinë, e cila, pas dy xhirove, ka grumbulluar katër pikë në fazën e grupeve. Anglia do ta zhvillojë edhe një ndeshje në fazën grupore, atë ndaj Panamasë.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Semi Pro" NTP, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën për riciklimin e mbeturinave të plastikës, në Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.08.2026 në ora 10:00 në Zyren e administratës, Kuvendi komunal, objekti i Ri, Komuna e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga "Semi-Pro" NTP, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Semi Pro" NTP, Prizren, për Fabrikën për riciklimin e mbeturinave të plastikës, në Prizren. <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "3A Aliu Group" sh.p.k, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për bazën e prodhimit të betoni, në Podujevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.08.2026 në ora 10:00 në Shkollën fillore dhe e mesme e ulet "Enver Maloku" Podujeve, do të organizohet debat publik nga "3A Aliu Group" sh.p.k, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "3A Aliu Group" sh.p.k, Podujevë, për bazën e prodhimit të betoni, në Podujevë. <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM PËR SHUARJEN VULLNETARE TË "INSTITUT IGH" D.D. - DEGA NË KOSOVË

Njoftojmë të gjithë klientët se "INSTITUT IGH" D.d. - Dega në Kosovë, me Numër Unik të Identifikimit: 810842717 me adresë të regjistruar: Rruga Ganimete Terbeshi, Nr. 26, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës, në ka marrë vendim mbi shuarjen/likuidimin vullnetar të shoqërisë

Njoftohen të gjithë Kreditorët eventuale që të paraqiten pranë kësaj shoqërie lidhur me ndonjë kërkesë eventuale ndaj korporatës, në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes në gazetë.

OBAVEŠTENJE O VOLONTERSKOJ LIKVIDACIJI "INSTITUT IGH" D.D. – FILIJALA U KOSOVU

Obaveštavamo sve klijente da je "INSTITUT IGH" D.d. – Filijala u Kosovu, sa jedinstvenim identifikacionim brojem: 810842717, registrovana adresa: Ulica Ganimete Terbeši, br. 26, 10.000 Priština, Republika Kosovo, doneo odluku o volonterskoj likvidaciji/zatvaranju kompanije.

Obaveštavamo sve potencijalne poverioce da podnesu svoja potraživanja prema kompaniji u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

NOTICE ON VOLUNTARY LIQUIDATION OF "INSTITUT IGH" D.D. – BRANCH IN KOSOVO

We hereby inform all clients that "INSTITUT IGH" D.d. – Branch in Kosovo, with Unique Identification Number: 810842717, registered address: Str. Ganimete Terbeshi, No. 26, 10,000 Prishtina, Republic of Kosovo, has decided to proceed with the voluntary liquidation/ closure of the company.

We notify all potential creditors to submit any claims they may have against the corporation within 30 days from the date of publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arbenita Salihu shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni".

- Ermir Kovaçi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjimnazit "Frang Bardhi".

- Florent Binai shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u. në Arbanë Prizren "Ibrahim Fehmiu".

- "AlfaA rent" LLC shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812343557.

- Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" LLC shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

